

Tabela e Permbajtjes

1	HYRJE.....	6
1.1	<i>Qellimi i punes dhe Objektivat e Studimit.....</i>	6
2	IDENTIFIKIMI I PROJEKTIT	9
2.1	<i>Hyrje.....</i>	9
3	STUDIMI TOPOGRAFIK.....	ERROR! BOOKMARK NOT DEFINED.
3.1	<i>Zona gjeografike</i>	11
4	PLANI I SHPRONESIMEVE.....	13
4.1	<i>Shtrirja Gjeografike e Projektit dhe Përdorimi i Tokës</i>	13
4.2	<i>Harta e Vlerave</i>	13
5	KRITERET E PROJEKTIMIT TE RRUGES.....	16
5.1	<i>Klasifikimi Rrugor.....</i>	16
5.2	<i>Elementet e gjemometrik të projektimit të rrugës në plan.....</i>	16
5.3	<i>Sekzioni Terthor i Autostrades.....</i>	16
6	STRUKTURAT.....	18
6.1	<i>Urat dhe strukturat dytësore të Projektit</i>	18
6.2	<i>Urat kryesore – Ura e Erzenit.....</i>	19
6.3	<i>Nënkalim me strukturë kompozite celik-b/a – Nënkalimi hekurudhor</i>	20
6.4	<i>Nënkalim me seksion drejtkëndor b/a – Nënkalimi i Maminasit</i>	23
6.5	<i>Nënkalimet me celik të valëzuar – Nënkalimi i Limutht.....</i>	23
6.6	<i>Mbikalim tip.....</i>	27
6.7	<i>Mbikalimi Pedonal Tipik.....</i>	27
6.8	<i>Propozimi përmbikalimin pedonal Tombino drejtkëndore betonarme</i>	28
6.9	<i>Tombino celiku me seksion të valëzuar.....</i>	28
6.10	<i>Muret Mbajtes</i>	29
7	METOLOGJIA E NDERTIMIT	32
7.1	<i>Pershkrimi i projektit.....</i>	32
7.2	<i>Sistemi i menaxhimit te devijimit te trafikut.....</i>	33
7.3-	<i>Ceshtjet Mjedisore</i>	34
7.4-	<i>Vendodhja e kantiereve</i>	35
7.5-	<i>Guroret, impiantet e copetimit, fabrikat e prodhimit miks te asfaltit dhe betonit</i>	35
8	PROPOZIME DHE NDERHYRJE NE INFRASTRUTUREN E PERGJITHSHME	39
9	NYJET NE DISNIVEL	45
10	ANALIZA E TRAFIKUT	55
10.1	<i>Zona e Studimit dhe Metodologja.....</i>	55
10.2	<i>Zhvillimi i Modelit te Trafikut.....</i>	55
10.3	<i>Rezultatet e modelit te trafikut.....</i>	56
11	PAKETA E SHTRESAVE RRUGORE	58
11.1	<i>Vleresimi Gjeologo-Inxhinierik</i>	58
12	BARRIERAT E SIGURISE.....	66
12.1	<i>Tipet e Pajisjeve të Sigurisë.....</i>	66
12.2	<i>Kriteret e përzgjedhjes dhe pajisjet e sigurisë rrugore</i>	66
13	BARRIERAT E SIGURISE.....	68
	<i>13 Kohezgjatja e Punimeve.....</i>	69

Listë e Figurave

Figure 1 – Ndarja e gjurmës se superstrades ne 3 segmente	8
Figure 2 - Harta e rajonit 1	9
Figure 3 - Harta e rajonit 2	9
Figure 4 – Superstrada Tiranë-Durrës	10
Figure 5 - Paraqitje skematike e gjurmës së projektit mbi zonat kadastrale të prekura	14
Figure 6 - Përbledhëse e Tokës së prekur nga Projekti (sipas llojit të përdorimit) dhe vlerat përkatëse	15
Figure 7 - Seksioni i autostradës.....	17
Figure 8 - Foto te Urës së Erzenit.....	19
Figure 9 - Seksion tërthor tipik i urës së Erzenit (gjëndja ekzistuese)	19
Figure 10 - Propozim i për zgjerimin dhe sigurimin e qëndrueshmërisë së Urës së Erzenit.....	20
Figure 11 - Seksion tërthor tipik I Nënkalimit Hekurudhor	20
Figure 13-Faza 1: Shp-A_Majtë & Shp-B_Djatht zjatimi I shpatullës dhe skarpatave të tyre	21
Figure 13 - Faza 2	21
Figure 14 - Faza 3	22
Figure 15 - Faza 4.....	23
Figure 16 - Propozimi për mdërhyrjet e zgjerimit të nënkalimeve b/a me seksion drejtëkëndor	23
Figure 17 - Propozimi për zgjerimin e nënkalimit të Limuthit.....	24
Figure 18 - Faza 1	25
Figure 19 - Faza 2	25
Figure 20 - Faza 3	26
Figure 21 - Faza 4	27
Figure 22 - Propozimi për mbikalimin tip	27
Figure 23 - Propozimi për zgjerimin e nënkalimit beton-arme me seksion drejtëkëndor	28
Figure 24 - Zgjerimi i Tombinove te celikut	29
Figure 25 - Seksioni terthor tip me mur mbajtes te armuar	30
Figure 26 - Seksioni terthor tip me mur gravitar	30
Figure 27 - Seksioni terthor tip me mur me pilotë	30
Figure 28 - Seksioni terthor tip me dhe te perforuar.....	31
Figure 29- F2 seksioni urban	39
Figure 30- Rrugë sekondare në krahun e majtë km2+100.....	40
Figure 31- Rrugë sekondare që kalon në pas City Parkut	40
Figure 32- Rrugë sekondare që kalon në hekurudhën opsioni i parë	41
Figure 33- Rrugë sekondare që kalon në hekurudhën opsioni i dytë	41
Figure 34- Rrugë sekondare që kalon në hekurudhën opsioni i tretë	42
Figure 35- Rruga Sekondare e Sukthit (Mbikalimi n.1)	42
Figure 36 – Rruga Sekondare e Fllakes (Mbikalimi nr 02)	42
Figure 37– Rruga Sekondare e Shen Vlashit (Mbikalimi nr 03)	43
Figure 38– Seksioni Tërthor i Mbikalimeve Tip	43
Figure 39–Propozimet e Nyjeve – Harta e Vendndodhjes	45
Figure 40 – Nyja e Kasharit - Opsiuni 1	46
Figure 41– Nyja e Kasharit - Opsiuni 2	47
Figure 42– Nyja e Vores	48
Figure 43 – Nyja e Lalzit – Opsiuni 1	49
Figure 44– Nyja e Lalzit - Opsiuni 2	50
Figure 45– Nyja e Sukthit.....	51
Figure 46 – Nyja e Shkozetit – Opsiuni 1	52
Figure 47– Nyja e Shkozetit – Opsiuni 2	53
Figure 48 – Nyja e D	54
Figure 49 – Propozimet per paketen e shtresave rrugore	64

Figure 50 – Propozimi per paketen e shtresave rrugore.....	65
Figure 51 - Llojet e Barrierave Antizhurme te Projektit.....	69

Liste e Tabelave

Tabela 1– Lista e strukturave te Projektit	18
Tabela 2 - Identifikimi I Klasës minimale të Barrierave të Sigurisë	67

LISTA E SHKURTIMEVE

SHKURTIMI	Percaktimi
€	Euro
AADT	Average Annual Daily Traffic
ARRSh	Albanian Road Authority
ANTP	Albania National Transport Plan
ARCS	Albanian Road Construction Specifications
ARDACS	Albanian Road Design and Construction Standards
ARDM	Albanian Road Design Manual
BoQ	Bill of Quantities
CA	Contracting Authority
CAPEX	Capital Expenditure
CBA	Cost-Benefits Analysis
CCR	Curvature Change Rate
KONSULENTI	SPEA Engineering SpA
DCF	Discounted Clash Flow
DD	Detailed Design
EBRD	European Bank for Reconstruction and Development
EIA	Environmental Impact Assessment
EMP	Environmental Management Plan
ENPV	Economic Net Present Value
ESIA	Environmental and Social Impact Assessment
FNPV	Financial Net Present Value
FS	Feasibility Study
GoA	Government of Albania
GDP	Gross Domestic Product

HCM	Highway Capacity Manual
IMC	Institute of Monuments of Culture
IMF	International Monetary Fund
INSTAT	Institute of Statistics
IGJEUM	Institute of Geosciences, Energy, water and Environmental
IR	Inception Report
IRR	Internal Rate of Return (E-economic, F-financial)
MCA	Multi-criteria Analysis
MoTI	Ministry of Transport and Infrastructures
NPV	Net Present Value
OD	Origin – Destination
PCU	Passenger Car Unit
PD	Preliminary Design
RoW	Right of Way
SEE	South East Europe countries
SEETO	South-East Europe Transport Observatory
ToR	Terms of Reference
VOC	Vehicle Operating Costs
VoT	Value of Time
WB	World Bank

1 HYRJE

- **Titulli i Projektit: "Studim - Projektim Zgjerimi i Superstrades Tirane - Durres"**
- **Vendi: Shqiperi**
- **Klienti:Autoriteti Rrugor Shqiptar**
- **Numri i Kontrates: 6547/11, date 03Gusht 2015**
- **Konsulenti: Spea Engineering S.p.A.**
- **Kohezgjatja e Projektit: 13 Muaj**

1.1 Qellimi i punes dhe Objektivat e Studimit

Autoriteti Rrugor Shqiptar i ka kushtuar vemendje te vecante realizimit te zgjerimit te Superstrades Tirane-Durres, duke qene se ky korridor rezulton te kete nje dimension strategjik shume te rendesishem per zhvillimin e vendit.

Si u tha me lart, Superstrada Tiranë – Durrës lidh dy qëndrat më të mëdha të vendit, Tiranën si kryeqytet dhe Durrësin si portin kryesor dhe vend turistik, sidomos për plazhin, i cili ka nje shtrirje të konsiderueshme Durrës – Golem – Mali i Robit. Në këtë mënyrë ky segment rruge është më i ngarkuar në trafikun e mjeteve dhe arrin kulmin në periudhën e verës, sidomos vitet e fundit me ndërtimin e autostrades se re Milot- Morine e më tej në drejtim të Kosovës, por pa lënë jashtë dhe zona të tjera të rajonit. Pikërisht kjo rritje e vazhdueshme e trafikut e ka bërë të domosdoshme studimin për zgjerimin e kësaj superstrade për ta sjellë në parametrat e nevojshëm përballimin e trafikut gjithmonë e më të rënduar. Por jo vetëm kaq sepse prej vitesh në këtë segment rruge ka patur dëmtime të shtresa rrugore, çarje, dëmtime ,ulje e gropëzime në gjatësi të konsiderueshme në të dy anët e rrugës, dhe veçanërisht në korsitë anësore (sidomos atë Vorë – Durrës).

Në vitin 2008 nga ana e ARRSH-se është përgatitur studimi dhe projektimi i përmirësimit të shtresa rrugore pikërisht duke patur parasysh dëmtimet e konsiderueshme të shfaqura në këtë segment, por ky projekt nuk u vu në zbatim sipas rekomandime te tij.

Në vitin 2009 është bërë një ndërhyrje riveshese vetëm në shtresat e sipërme asfaltike, e konceptuar kjo vetëm si ndërhyrje e përkohëshme, apo mirembajtjeje, ku pas një farë kohe u shfaqën përsëri dëmtime gjate gjithe segmenteve me problematike. Me pas janë bërë përsëri ndërhyrje të pjesëshme në zonat e dëmtuara, por tashme rezulton e domosdoshme dhe emergjente studimi dhe projektimi për përmirësimin edhe te shtresa te tjera rrugore të aksit ekzistues. Natyrisht kjo e kordinuar në këtë rast me zgjerimin e superstradës.

Studim-Projetimi per Zgjerimin e Superstrades Tirane-Durres ka per objektiv kryesor projektimin e nje infrastrukture te kategorise "A", e cila duhet te kete karakteristikat per te perballuar volumet gjithnjë e ne rritje te trafikut ne kete arterie kryesore te vendit, si dhe te permiresoje gjendjen e shtresa rrugore ekzistuese tashme tejet te amortizuara ne nje pjese te madhe te Superstrades, duke ofruar keshtu nje nivel te pershatatshem sherbimi per kete kategori rruge.

Ne Ternat e References ishte parashikuar qe infrastruktura e re te projektohej ne perputhje me Standartin Shqiptar te Projektimit te Rrugeve (KTP 2001). Ne takimin e pare te zhvilluar me Klientin (ARRSH) me date 16.09.2015 Konsulentit ju kerkua te perdoren standartet e reja te miratuara (VKM Nr.628 date 15.07.2015 "Per miratimin e rregullave teknike te projektimit dhe ndertimit te rrugeve") per projektimin e kesaj vepre te infrastrukturese se transportit. Kjo kerkese u pranua nga ana e Konsulentit, i cili ka proceduar me projektimin inxhinierik sipas kerkesave dhe standarteve te reja ne fuqi.

Fazar e Projektit qe do te zhvillohet nga ana e Konsulentit jane:

- Projekt Ideja Paraprake
- Projekt Ideja Perfundimtare
- Draft Projekt Zbatimi
- Projekt Zbatimi Perfundimtar

Konsulenti ka perfshire ne studim këtë segment supertrade duke filluar nga dalja e mbikalimit të Kamzës (rreth 800 m nga mesi i mbikalimit) deri ne përfundimin në hyrje të Durrësit duke përfshirë dhe kryqëzimin e Dajlanit.

Studim-Projektimi i zgjerimit te Superstrades Tirane-Durrës do te permbate dhe studimet dhe komponentet e tjera qe perbejne bazen e vleresimeve dhe arsyetimeve te projektit, te cilat jepen si me poshte:

- Studimi topografik,
- Studimi gjeologjik dhe gjeoteknik,
- Studimi hidrologjik,
- Percaktimin e menyres me te mire per zgjerimin, vleresim te kostos se ndertimit,
- Zgjidhje gjeometrike te pershtatshme per zgjerimin,
- Zgjidhje per sistemin e Drenashimit
- Analiza dhe parashikimi i trafikut (per nje periudhe 20 vjecare),
- Studimi dhe projektimi i paketes se shtresave rrugore,
- Projektimin e sinjalistikes horizontale dhe vertikale si dhe te komponenteve te sigurise rrugore,
- Barrierat antizhurme,
- Spostimin e sherbimeve komunale ekzistuese (ujeselles kanalizime, elektrike, telefonike),
- Metodologjine e Ndertimit,
- Raporti i Shpronesimeve,
- Konsultimet me Publikun,
- Vleresimi i Ndigjimeve Mjedisore (VNM), dhe preqitja e planeve te menaxhimit dhe monitorimit mjedisor,
- Vleresimin e kostos se ndertimit,
- Analiza Ekonomike dhe Financiare e investimit.

Mbi bazen e te dhenave te perftuara nga studimet dhe analizat e mesiperme, Konsulenti do te realizoje projektimin inxhinierik, vizatimet perkatese, si dhe do te llogarise volumet e punes dhe preventivin e punimeve.

Realizimi i kesaj rruge ka nje dimension te rendesishem strategjik si pjese e korridorit Durrës–Morine, Korridorit Veri-Jug qe lidh Korridorin VIII Pan – Europian, pjese e rrjetit SEETO si dhe e Planit Kombtar te Transportit te propozuar nga Qeveria Shqiptare.

Gjithashtu, Konsulenti do te trajtoje vecanerisht:

- Kryqëzimet dhe mbikalimet në këtë segment rrugor duke bërë rivlerësimet e nevojshme të tyre mbështetur në parametrat e zgjerimit të rrugës dhe të trafikut. Në studimin e vet konsulenti ka marrë parasysh mosndërrerjen e trafikut gjatë zhvillimit të punimeve.

- Sistemimin e kanalizimeve sidomos në pjesën e parë Tiranë – Kashar e më tej deri në Vorë, duke qënë se kemi të bëjmë me një zonë tërësisht industriale dhe rrugë dytësore nga të dy anët. Konsulenti ka mbledhur gjithë informacionin e nevojshëm për studimet e tanishme dhe në perspektivë të kanalizimeve apo dhe të rrjeteve të tjera inxhinierike që mund të vinë nga Tirana nëpërmjet rrugës së Durrësit.
- Mundësinë e lidhjes me rrugë dytësore të pjesës Vorë – Durrës në mënyrë të veçantë në krahun e djathtë. Por në çdo rast lidhjet e këtyre rrugëve dytësore me rrugën kryesore do të bëhen vetëm nëpërmjet kryqëzimeve. Vlen për tu theksuar se në të dy anët e rrugës Vorë – Durrës janë ndërtuar objekte të ndryshme kryesisht me karakter biznesi. Edhe në këtë rast lidhja e këtyre ndërtimeve mund të studohet vetëm nëpërmjet kryqëzimeve.

Projekti per zgjerimin e Superstrades eshte studiuar per gjithësisht sipas tre segmenteve:

1. Segmenti Tirane-Vore
2. Segmenti Vore-Sukth
3. Segmenti Sukth-Durrës



Figure 1 – Ndarja e gjurmës se superstrades ne 3 segmente

2 IDENTIFIKIMI I PROJEKTIT

2.1 Hyrje

Superstrada Tirane – Durrës (e njohur ne vend qe prej viteve '90 si Autostrada) fillon nga Mbikalimi i Kamzës deri tek Ura e Dajlanit, është një nga arteriet kryesore dhe më të rëndësishme të vendit, e cila lidh dy qendrat me te mëdha administrative, industriale, kulturore dhe turistike të Shqipërisë, si dhe korridoret Veri Jug dhe atë Lindje-Perëndim. Gjithashtu, një pjesë e kësaj rruge, segmenti Vorë - Durrës, është arteria kryesore e korridorit Durrës-Kukës-Morinë, i cili në rrjetin Evropian të rrugëve emërohet E851. Korridori Veri Jug lidhet me Autostradën në qytetin e Vorës nëpërmjet Segmentit E762. Shiko Figurën e mëposhtme (Figura 1).




Figure 2 - Harta e rajonit 1

Ndërsa Korridori Lindje-Perëndim fillon në Qafë-Thanë dhe vazhdon më pas në qytetet Librazhd, Elbasan, Tiranë (E852) dhe përfundon në qytetin e Durrësit. Shiko Figurën e mëposhtme: (Fig.2):




Figure 3 - Harta e rajonit 2




Figure 4 – Superstrada Tiranë-Durrës


3 STUDIMI TOPOGRAFIK

Ky kapitull pershkruan Studimin Topografik te realizuar per pergatitjen e Zgjerimit te Autostrades Tirane – Durres. Zona nen studim perfaqeson nje nga arteriet kryesore te infrastruktureve ne vend, e cila mbledh volume te larta trafiku.

Vezhgimet topografike u realizuan nga Konsulenti gjate muajve Shtator dhe Tetor, se bashku me detajime te realizuara gjate muajit nentor- dhjetor.

3.1 Zona gjeografike

Zona ne studim per projektin ndodhet ndermjet zones urbane te Tiranes dhe qytetit bregdetar te Durresit. Gjatesia totale e rruges eshte rreth 31km, dhe gjate studimit u mblodh informacion per nje distance mesatare prej 60 – 80m ne cdo ane per aksin ekzistues rrugor.



4 PLANI I SHPRONESIMEVE

Qëllimi i këtij Raporti është të bëjë një vlerësim të vlerës paraprake të shpronësimeve potenciale, vlerësim i cili është bazuar në identifikimin e pasurive të afektuara nga projekt, përdorimi i tokës përgjatë gjurmës së projektit, dhe identifikimi i vlerave aktuale të aplikuara nga shteti shqiptar për qëllime shpronësimi. Kjo është realizuar për zonat kadastrale të përshkruara nga projektet dhe identifikimin e pasurive që mund të preken nga projektet.

4.1 Shtrirja Gjeografike e Projektit dhe Përdorimi i Tokës

Zona e studiuar është e shtrirë midis qytetit të Tiranës, afersisht 800m në perëndim të mbikalimit të kamzës, dhe Qytetit të Durrësit, në lindje të "Urës së Dajlanit".

Bashkitë e prekura nga gjurma e Projektit janë :

- Tirana;
- Vora;
- Shijaku;
- Durrësi.

Pjesa lindore e zonës së studiuar, është pjesë e bashkisë së Tiranës, dhe përfshin Njësinë Administrative të Kasharit, kryesisht më ndërtesa të stabilizuara industrial. Gjithashtu ndërtimë të reja industrial janë të planifikuara në këtë zonë. Pjesa perëndimore e studimit, është pjesë e Bashkisë së Durrësit, me ndërtesa rezidenciale dhe industrial të shtrira përgjatë projektit.

Në zonën e studimit janë identifikuar gjithashtu parcel-tokë bujqësore, kryesisht midis Vorës dhe Shkozët. Pjesa më e madhe e sipërfaqes së prekur nga projektet është identifikuar si rrugë ekzistuese dytësore, kanale e skrapate, të cilat në raportin paraprak nuk kanë një vlerë, meprezumimin që këto paasuri janë shpronësuar më parë (duke l konsideruar pasuri "shtet", në administrim te ARRSH). Nga verifikimi ne regjistrat e pasurive të paluajtshme, pranë Zyres së Registrimit të Pasurive të Paluajtshme, rezulton se këto pasuri, nuk janë regjistruar ende në pronësi Shtet.

Përgjatë gjurmës së projektit janë planifikuar disa alternative Interchange, sinë Kashar, Vorë, Lalz e Sukth e Shkozët. Këto Interchange janë pjesë e projektit dhe për secilën prej tyre janë iidentifikuar pasuritë e prekura dhe vlerat përkatëse.

4.2 Harta e Vlerave

Gjurma e projektit prek 19 fshatra (zona kadastrale), në qarkun e Tiranës dhe Durrësit, duke përfshirë gjithashtu edhe 3 zona kadastrale të qytetit të Durrësit, për të cilat l kemi prezantuar në tabelën e hartës së vlerave, së bashku me një paraqitje të skematike të gjurmës së projektit mbi zonat kadastrale të prekura.




Figure 5 - Paraqitje skematike e gjurmës së projektit mbi zonat kadastrale të prekura

Në tabelën më poshtë, është paraqitur një përbledhje e tokës së prekur nga projektit (sipas llojit të përdorimit) dhe vlerat respektive. Llogaritjet e detajuara, me detaje mbi numrin e pasurisë së afektuar dhe vlerat përkatëse, si për Gjurmën dhe për nyjen është përgatitur në formatin Excel, bashkëlidhur këtij raporti.

Vlera Totale mund të ndryshojë në fazën finale, pas konfirmimit të statusit ligjor të pasurive të prekura nga Zyrat e regjistrimit të Pasurive, Tiranë dhe Durrës.

Emertimi	Siperfaqe toke "Shtet" rruge/kanale/etj (m ²)	Siperfaqe Toke Bujqesore	Vlera Toke Bujqesore (Leke)	Siperfaqe Toke Truall	Vlera Toke Truall (Leke)	Siperfaqe Ndertimi
GJURMA E PROJEKTIT	80,111	753,492.92	445,651,494.20	68,142	269,416,536.19	20,382
VARIANTI 1 - SHKOZET	625	10,926	3,353,249	14,491	172,070,637	1,329
VARIANTI 2 - SHKOZET	143	973	45,666	9,287	109,400,247	-
VARIANTI 1 - LALZI_1	6,523	8,017	2,243,655	3,642	2,313,343	7,300
VARIANTI 1 - LALZI_2	5,488	9,497	22,948,327	3,084	1,690,472	1,219
VARIANTI 1 - VORA_1	1,305	6,987	3,705,084	4,556	11,172,489	3,027
VARIANTI 1 - QAFE KASHARI_1	-	8,909	3,991,304	270	1,147,079	-
VARIANTI 1 - QAFE KASHARI_2	-	8,752	3,791,661	468	1,985,553	
VARIANTI 1 - SUKTH	-	3,251	1,290,818	-	-	-
SHUMA	94,195	810,806	487,021,257	103,941	569,196,356	33,256
SHUMA (EUR)	€ 677.66	€ 5,833.13	€ 3,503,750.05	€ 747.78	€ 4,094,937.81	€ 239.25
SIPERFAQE TOTALE E PREKUR (m)						

Figure 6 - Përbledhëse e Tokës së prekur nga Projekti (sipas llojit të përdorimit) dhe vlerat përkatëse

5 KRITERET E PROJEKTIMIT TE RRUGES

5.1 Klasifikimi Rrugor

Autorruga e Kategorise "A"

Autorruga "A" do te konsiderohet nje Rrugë ndër-urbane ose urbane me karrekhata të pavarura ose të ndara nga trafik ndarës të pa kapërcyeshëm, secila me të paktën dy korsi lëvizjeje, bankinë të shtruar të mundshme në të majtë dhe korsi emergjencë, ose bankinë të shtruar në të djathtë, pa ndërkëmbime në nivel dhe pa lidhje te drejtperdrejtë hyrje e dalje me prona private, e pajisur me rrëthim dhe sisteme asistence për përdoruesin gjatë gjithë gjatësisë, e rezervuar për qarkullimin e disa kategorive automjetesh me motorr dhe e dallueshme me sinjale të vecanta të fillimit dhe mbarimit. Për qëndrimin duhet të jenë parashikuar zona të caktuara me hyrje e dalje, të pajisura përkatësisht me korsi ngadalësimi dhe perspektimi.

Të dhëna kryesore:

- Shpejtësia minimale e projektimit $V_p=90$ km/orë,
- Shpejtësia maksimale e projektimit $V_p=140$ km/orë,
- Zgjidhja bazë me 3+3 korsi kalimi, dhe korsi emergjencë nga të dyja anët,
- $TDMV = 24000 - 67000$ mjete/24orë.

5.2 Elementet e gjeometrik të projektimit të rrugës në plan

5.2.1 Lakoret rrethore

Për lakimet rrethore rrezet duhet të përzgjidhen aq të mëdha sa të jetë e mundur sipas topografisë, në mënyrë që të arrihet: distancë shikimi për parakalim të mjaftueshem;ruajtjen e njëtrajtshmërisë gjatë drejtimit.

Rrezja minimale ne lidhje me shpejtësine e projektimit është **1100m**.

Llogaritjet e pamshmerisë janë realizuar më një pikë vështrimi prej 1.1m dhe lartësi objekti prej 0.1m.

5.2.2 Lakoret vertikale

Ne pervijimin gjatesor te rruges zakonisht si mjet rakordimi përdoren lakoret parabolike por eshte krejtesisht e pranueshme qe te perdoren edhe harqet e thjeshta rethor me rreze me te madhe se 1500m duke perafruar ne kete menyre parabolen teorike me nje hark rethor te përafërt.

Gjatësia e lakores vertikale duhet të jetë minimalisht **60 m**.

5.3 Seksioni Terthor i Autostrades

Sipas TeR të realizuara për objektin, si edhe duke iu referuar standardeve shqiptare në fuqi dhe vecanerisht Vendimit te Këshillit të Ministrave Nr. 628, datë 15.7.2015, Për miratimin e Rregullave Teknikë të Projektimit dhe Ndërtimit të Rrugëve.

Seksioni tip i cili përbush kërkesat e TeR është paraqitur më poshtë.

5.3.1 Seksione Terthor Tip

Të dhëna kryesore

- Shpejtësia minimale $V_p=90$ km/orë,
- Shpejtësia maksimale $V_p=140$ km/orë,
- Zgjidhja bazë me 3+3 vija kalimi dhe korsi emergjence nga të dyja anët.
- $TDMV=24000 \div 67000$ mjetë/24 orë




Figure 7 - Seksioni i autostradës

Sekioni tërthor i përdorur në projekt është i përbërë me tre vija kalimi. Gjëresia totale e rrugës është 35.10m. Në këtë gjërsëi do kemi pjesën qëndrore në të cilën dojen pozicionuar dy trafik ndarës dhe dy bankina të veshura në secilën anë. Në dy anët e secilit drejtim dojen dy korsi emergjence dhe dy bankina të pavesura me gjëresi prej 1.3m në secilin krah.

Gjëresia e korsisë

Gjëresia e korsisë së kalimit për këtë kategori rrugë është 3.75m dhe korsia e emergjencës është konform normave dhe seksionit tip për këtë kategori, 3.0m

Gjëresia e bankinës

Gjëresia e bankinës së pavesur përrugën e kategorisë "A" të projektit të propozuar është marë 1.30m, kjo për të patur mundësi për të vendosur guard rail apo rrëthimin e autostradës.

Mbingritja e trasesë së rrugës

Mbingritja e trasesë së rrugës është 7%, në pjesën lako të kthesës. Në pjesën e lakojeve me rreze të ndryshueshme mbilartësimi është gradual dhe është shfrytëzuar gjithë gjatësisë së saj.

Distanca e shikimit për ndalim

Kontrolllet për distancën e shikimit në projekt janë bërë për një distancë shikimi për ndalim $L=200$ m, kjo distancë ka diktuar dhe zgjerimin e disa kthesave për të rritur pamshmërinë e rrugës. Më sipër janë përmenduar të gjitha kthesat ku ndërhyjmë për të realizuar zgjerimet për pamshmërine e rrugës.

Gjëresia e trafik-ndarësit.

Gjëresia e trafik ndarësit është 2.6m distanca ku do vendosen dy trafik ndarësit prej betoni me një hapësirë bosh midis tyre dhe dy shirita prej 0.7m në secilen anë duke e bërë gjëresine totale të trafik ndarësit 4.0m

në lëvizjen e mjeteve dhe për të qënë në rregull konform normave në fuqi.

6 STRUKTURAT

6.1 Urat dhe strukturat dytësore të Projektit

Urat dhe viaduktet, bashkë me strukturat minore të autostradës sic janë mbikalimet, nënkalimet, tombinot e kështu me radhë, mundësojnë kalimin e pengesave sic janë lumenjtë, luginat, rrugët, linjat hekurudhere, rrugët e këmbësoreve, etj.

Pasi janë ekzaminuar të gjitha strukturat e kryesore dhe ato dytesore për projektin në fjalë u bë e mundur kategorizimi i tyre si vijon më poshtë:

- Urat: ky grupim përfshin vetëm urën e Erzenit;
- Nënkalimet: kjo kategori përfshin nënkalimet me trarë poshtë pjesës së kalueshmë, telajo monolitike e strukturës dhe ndërtime Tubosider;
- Tombinot: janë struktura beton-armeje me seksion rrrethor ose drejtëkëndor
- Mbikalime Rrugore;
- Mbikalimet pedonale;
- Tombinot Reethore dhe Kuti

Tabela e mëposhtme përmblehdh listën e strukturave të cilat janë pjesë e projektit qe po shqyrtohet.

Nr.	Emërtimi	Ura	Mbikalim	Nënkalim	Mbikalim Pedonal	Tombino
1	<i>Mbikalimi i Kasharit</i>		1			
2	<i>Nënkalimi i Limuthit</i>			1		
3	<i>Nënkalimi i Vora 1</i>			1		
4	<i>Nënkalimi i Gërdecit</i>			1		
5	<i>Nënkalimi i Maminasit</i>			1		
6	<i>Mbikalimi i Lalzit</i>		1			
7	<i>Mbikalimi i Guzajt</i>			1		
8	<i>Mbikalimi i Sukthit</i>		1			
9	<i>Ura e Erzenit</i>	1				
10	<i>Nënkalimi i Sallmones</i>			1		
11	<i>Nënkalimi Hekurudhor</i>			1		
12	<i>Mbikalimi i Fllakës</i>		1			
13	<i>Mbikalimi i Shën Vlashit</i>		1			
14	<i>Mbikalimi i Shkozetit</i>		1			
15	<i>Mbikalimi Tip Pedonal</i>					1
16	<i>Tombino drejtkëndor</i>					17
17	<i>Tombino rrethor</i>					38

Tabela 1– Lista e strukturave te Projektit

6.2 Urat kryesore – Ura e Erzenit

Projekti përfshin vetëm një strukturë ure. Kjo është ura e Erzenit, e cila përshkruhet si vijon më poshtë.

Ura ekzistuese e autostradës Tiranë-Durrës mbi lumin e Erzenit, një ndër lumenjtë kryesor të Shqipërisë e ka vendodhjen në Pk. 22+466.80 (ref. Projektit të Rrugës).



Figure 8 - Foto te Urës së Erzenit

Ura e Erzenit është e përbërë nga , 33 m e gjatë, më një gjatësi totale rreth 100 m, siç tregohet edhe në figurën e mëposhtmë.




Figure 9 - Seksion tërthor tipik i urës së Erzenit (gjendja ekzistuese)

6.2.1 Propozimi për ndërhyrjet e zgjerimit dhe përmirësimit të strukturës

Zgjerimi i autostradës kërkon një seksion të rrugës automobilistike me **3 korsi trafiku**, gjërsi **3.75 m** të gjerë dhe një korsi **emergjencë 3.00 m** për cdo karrehatë, me një zone trafikndarëse **2.60 m**, zgjerimi i urës kërkon gjithashtu edhe shtimin me 8.25 m të secilës nga pjesët kaluese, sic tregohet në figurën e mëposhtme.




Figure 10 - Propozim i për zgjerimin dhe sigurimin e qëndrueshmërisë së Urës së Erzenit

6.3 Nënkalim me strukturë kompozite celik-b/a – Nënkalimi hekurudhor

Projekti përfshin vetëm një nënkalim me strukturë kompozite celik-beton arme. Ky është një nënkalim hekurudhor, e cila është përvleruar shkurtimisht më poshtë.




Figure 11 - Seksion tërthor tipik I Nënkalimit Hekurudhor

Një përvlerim i shkurtër i të gjithë fazave të punës për të realizuar zgjerimin e veprës është paraqitur më poshtë

Faza 1

Ndërtimi i Shp-A_Majtë & Shp-B_Djathtë zgjatimi i shpatullës dhe skrapatave të tyre respektive. Trafiku në të dyja karrehatat.




Figure 12-Faza 1: Shp-A_Majtë & Shp-B_Djathtë zgjatimi i shpatullës dhe skrapatave të tyre

Faza 2

Faza 2 konsiston në hapat e mëposhtëm:

- Mbylljet karrehatat në drejtimin Tirana-Durrës, spostohet trafiku ne karrehatën tjetër.
- Ndërtohet në zonën e djathë një murë provizor mbajtës me pilota
- Prishja e zonës trekëndore të pjesës kaluese në zonën e djathë
- Prishja e murit të djathët mbajtës
- Ndërtimi i Shp-A zgjerimit të shpatullës
- Ndërtimi i murit të ri mbajtës së pjesës së djathë
- Ndertimi i pjesës së re kaluese
- Ndërtimi i pjesës së djathët të zgjerimit të skrapatës
- Punimet e mbyllijes së finiturës

Ndërtimi dhe zgjerimi i themelit të shpatullave përkon me themelin e murit mbajtës ekzistues. Me qëllimin për të shfrytëzuar pilotat ekzistuese, do të vendosen vetëm ndërmjet këtyre të fundit, duke u siguruar që aftësia mbajtëse e tyre plotëson kriteret e qëndrueshmërisë së strukturës.




Figure 13 - Faza 2

Faza 3

Faza 3 konsiston në hapat e mëposhtëm

- Hapja e trafikut nga karrekhata Tiranë-Durrës, mbyllja e karrekhës Durrës-Tirana.
- Ndërtimi i murit mbajtes me pilota provizor në pjesën e majtë
- Prishja e zonës trekëndore të pjesës kaluese në zonën e majtë
- Prishja e murit të majtë mbajtës
- Ndërtimi i pjesës Shp-B_Majtë zgjerimit të shpatullës
- Ndërtimi i murit të ri mbajtës bë pjesën e majtë
- Ndertimi i pjesës së re kaluese
- Ndërtimi i zgjerimit të skarpatës në anën e majtë
- Mbyllja e punimeve




Figure 14 - Faza 3

Faza 4: Konfigurimi përfundimtar

Konfigurimi përfundimtar paraqitet në figurën e mëposhtme.




Figure 15 - Faza 4

6.4 Nënkalim me seksion drejtkëndor b/a – Nënkalimi i Maminasit

Projekti përfshin disa nënkalime me seksion drejtëkëndor. Për të përfaqësuar këtë kategori është përgjedhur nënkalimi i Maminasit për shkak të rëndësisë së tij dhe dimensioneve.

6.4.1 Propozimi për ndërhyrjet e zgjerimit dhe përmirësimit të strukturës

Konfigurimi i zgjerimit paraqitet në figurën më poshtë.




Figure 16 - Propozimi për mdërhyrjet e zgjerimit të nënkalimeve b/a me seksion drejtëkëndor

6.5 Nënkalimet me celik të valëzuar – Nënkalimi i Limuthit

Projekti përbën dy nënkalime me celik të valëzuar (të prodhuar nga Tubosider s.p.a). Këto janë nënkalimi i Limuth-it dhe i Sallmone. Struktura më përfaqësuese dhe në kushte më të disfavorshme qe do të trajtohet përzgerim është nënkalimi i Limuth-it, i përshkruar në mënyrë të detajuar si më poshtë.

Konfigurimi i zgjeruar i nënkalimit të Limuth-it është paraqitur më poshtë:




Figure 17 - Propozimi për zgjerimin e nënkalimit të Limuthit

Më poshtë jepet një përshkrim i shkurtër i fazave të punimeve për të realizuar zgjatimin.

Faza 1

Në ketë fazë duhen bërë disa punime gërmimi në distancë 5- 7 m nga muri, në mënyrë qe të lejohet prishja e murit dhe proceset e tjera të ndërtimit.



Figure 18 - Faza 1

Faza 2

Faza 2 përbëhet kryesisht nga hapat e mëposhtëm:

- Soleta konsol duhet të prishet. Gjatë këtij procesi, duhet pasur shumë kujdes që most është prishen panele metalike të HPA-së, të cilat në rast dëmtimi duhet të zëvendësohen.
- Prishja e murit anësor dhe zhvendosja e mbushjes anësore. Gërmimet duhet të jenë me gjëresi dhe gjatësi të mjaftueshme në mënyrë që të sigurohet stabiliteti i skrapatës dhe lehtesar ndërtimin e paketës teknike të HPA-së.
- Prishje e murit mbajtës dhe trotuarit. Prishjet dhe gërmimet duhet të arrijnë kuotën e fillimit të themelit të nënkalimit të tipit Tubosider.




Figure 19 - Faza 2

Faza 3

Faza 3 përbëhet kryesisht nga hapat e mëposhtëm:

- Hedhja e betonit për pjesën e parë të themelit të HPA-së.
- Bashkimi i paneleve të valëzuara metalike, siç tregohet në figurën e mësipërme.
- Procesi tjetër është hedhja e betonit të varfër.
- Montimi i armaturave në traun e bordurës ekzistuese.
- Ndërtimi i trarëve të brendshëm të shtytjes;




Figure 20 - Faza 3

Faza 4

Faza 4 përbëhet kryesisht nga hapat e mëposhtëm:

- Mbushje anësore deri në arritjen e nivelit të traut të shtytjes.
- Ndërtimi i trarëve të bordurës , si më poshtë.
- Ndërtimi i trarëve të brendshëm të shtytjes;




Figure 21 - Faza 4**Faza 5**

Faza 5 konsiston në ndërtimin e paketës teknike (argjinaturës anësore mbajtëse) siç tregohet në skemën e mëposhtme.


Për shtresën e fundit para themelit të rruget, është e rekomandueshme realizimi i një shtrese me trashësi minimale $t=30\text{cm}$ e grupit të materialeve $A_1 - A_{2-4} - A_{2-5}$, sipas specifikimeve të dhëna nga AASHTO M145-91.

6.6 Mbikalim tip

Projekti përfshin disa mbikalime të cilët përgjithësisht kanë nevojë të rindërtohen si pasojë e nevojës për të mbuluar një distancë më të madhe. Propozimi për mbikalimin tip është përshkruar shkurtimisht sic vijon më poshtë.

6.6.1 Përshkrim i përgjithshëm i propozimit për mbikalimin tip

Trarë kryesorë 1.20 m të gjatë dhe me trashësi 0.30 m. Pilat e inklinuar prej celiku për secilin tra janë të fiksuar në themelet e zakonshëm. Shpatullat dhe pilat janë të fiksura në themele me pilotë me fërkim me diametër $\varnothing 1200$ mm.

**Figure 22 - Propozimi për mbikalimin tip**

Mbikalimet ne studim jane :

1. Mbikalimi Hekurudhor ne Rrugjen Sekondare te Vores
2. Mbikalimi Hekurudhor ne Nyjen e Lalzit

6.7 Mbikalimi Pedonal Tipik

Projekti përfshin disa mbikalime pedonale të cilat janë të pozicionuara në vendodhje të ndryshme përgjatë trajektores së rruget, të cilat kanë nevojë të rindërtohen si rrjedhojë e zgjerimit të rruget ato duhet të mbulojnë hapësirë më të madhe.. Një strukturë përfaqësuese tregohet në figurën e mëposhtme.

Pershkrim i përgjithshëm i propozimit për mbikalimet pedonale:

Përgjatë rruget ekzistuese Tiranë – Durrës është e mundur të shihen dy lloje të ndryshme mbikalime pedonale. Të dyja këto janë konstruktione celiku por e para është e vjetëruar, ndërkohë e dyta është e re dhe është me formë harku shumë të këndëshme.

Kjo lloj strukture do të adaptohet sipas zgjerimit të rruget por duke mbajtur të njëjtën tipologji si në figurën e mëposhtme.

6.8 Propozimi për mbikalimin pedonal Tombino drejtkëndore betonarme

Kjo strukturë është një nënkalim drejtëkëndor beton-arme me gjatësi aksiale 19.60 m dhe gjerësi 3.00 m. Soleta ka një trashësi 0.30 m ndërsa muret janë të lartë 2.00 m.

Zgjerimi i pjesës së kalueshme, kërkon që struktura të zgjerohet nga të dyja anët.

Nënkalimet e rinj drejtëkëndor do të kenë të njëjtien shtrirje si nënkalimi ekzistues, i vendosur përpendikular me aksin e rruget, në mënyrë që të arrihet zgjerimi sipas rruget së re.

Konfigurimi i zgjerimit paraqitet në figurën më poshtë.




Figure 23 - Propozimi për zgjerimin e nënkalimit beton-arme me seksion drejtëkëndor

6.9 Tombino celiku me seksion të valëzuar

Projekti përfshin disa tombino prej celiku me seksion të valëzuar me dimensione të ndryshme të pozicionuar përgjatë rruget (ref. projektit të rruget). Dimensionet dhe seksionet e tyre varojnë nga $\phi 1000$ në $\phi 2000$ (seksion rrerhor) deri në seksion harkor 3.06×2.13 , 3.32×2.33 , 3.69×3.06 , 4.08×3.35 dhe 5.21×3.34 .

Në figurën e mëposhtme tregohet konfigurimi i zgjerimit të strukturës.




Figure 24 - Zgjerimi i Tombinove te celikut

6.10 Muret Mbajtes

6.10.1 Gjeometria

Ne Anekset e raportit perkates shpjegohen detajet kostruktive te tipologjive te ndryshme te strukturave, te cilat ne menyre te permbledhur dhe shkurtimisht jepen si me poshte:

Mure mbajtes te armuar:

- 2.5 m te larte
- 3.5 m te larte
- 4.5 m te larte
- 5.5 m te larte

Mur gravitar:

- 1.0 m te larte
- 1.5 m te larte
- 2.0 m te larte

Mur me pilota:

- 12.0 m te gjate ($d=0.8m$, $s=1.00m$)

Dhe i perforuar:

- variabel deri ne 6m




Figure 25 - Seksioni terthor tip me mur mbajtes te armuar




Figure 26 - Seksioni terthor tip me mur gravitar




Figure 27 - Seksioni terthor tip me mur me pilota




Figure 28 - Seksioni terthor tip me dhe te perforuar

7 METODOLOGJIA E NDERTIMIT

7.1 Pershkrimi i projektit

Qellimi i projektit konsiston ne zgjerimin e Autostrades ekzistuese Tirane – Durrës, per nje shtrirje totale prej 30+930 km, nepermjet realizimit te nje korsie te trete dhe rritjen e standartit te rruges ne nje Supertrade A1 duke perfshire permiresimin e strukturese se trashesise se shtresave.

Zbatimi i Punimeve planifikohet per ndarjen ne 3 Lote, te specifikuara si me poshte:

- | | |
|--|--|
| - Loti 1 Mbikalimi Kamez – Vore | Gjatesia Totale e Planifikuar 11+700 km; |
| - Loti 2 Vore - Sukth | Gjatesia Totale e Planifikuar 10+300 km; |
| - Loti 3 Sukth – Durrës (Nyja e Dajlanit) | Gjatesia Totale e Planifikuar 8+922 km; |

Proceset ndertimore:

Punimet kryesore te pritshme per tu realizuar pergjate 3 loteve jane te permblehdura me poshte:

- 1) Pergatitja e devijimit te mjeteve te trafikut
- 2) Pastrimi i zones se zgjerimit
- 3) Ndertimi i strukturave ndihmese ne bashkine e Vores ndermjet km 10+300 – km 11+500 (rrethrrrotullime, nenkalime dhe rampat e aksesit)
- 4) Pastrimi i zones se zgjerimit
- 5) Rialokimi i kanaleve paralele ekzistuese te drenazhit
- 6) Heqja dhe rindertimi i mbikalimeve ekzistuese te kembesoreve
- 7) Heqja e siperfaqes ekzistuese te asfaltit
- 8) Germimi ne klasen dhe linjen e strukturave ekzistuese te shtresave
- 9) Ndertimi i strukturave te reja te shtresave
- 10) Germim i paklasifikuar per zgjerimin e korsise se trete mbi dhera te paqendrueshem dhe/ose te bute
- 11) Mbushja dhe kompaktimi i germimeve te mesiperme nga materiali I zgjedhur
- 12) Shtrimi i Binderit dhe Asfaltit perfshire edhe zgjerimet me vend qendrim.
- 13) Shkaterrim/Ndertim i strukturave ekzistuese te medha (Perkatesisht 3: mbikalimi km 25+500 nenkalimi km 28+10 dhe mbikalimi I Shkozetit km 29+100)
- 14) Zgjatim i strukturave ekzistuese te medha (Perkatesisht 1 – vendndodhja lokale ne mbikalimin ne nyjen e Kasharit)
- 15) Zgjatim i strukturave ekzistuese te drenazhit
- 16) Zgjatje e nenkalimeve ekzistuese te medha
- 17) Rialokim/Ndertim i nenkalimeve ekzistuese (Perkatesisht 5: km 18+006, km 19+696, km 20+702, km 20+979, km 21+600)
- 18) Sinjalistike e re vertikale dhe horizontale
- 19) Sinjalistike rrugore shtese (Guard rails me reflektore, Kone reflektore sy mace, police i shtrire, Vijezi me reliev, etj.);
- 20) Ndertim/Rindertim I vijadukteve dhe tubacioneve te nendheshem te sherbimeve komunale
- 21) Shtrese bimesie ne bankina
- 22) Rrethim me gardh
- 23) Heqja e rampave te perkohshme dhe devijimeve te perkohshme te trafikut
- 24) Heqja e strukturave te devijimit te trafikut dhe sinjalistikes se perkohshme, perfshire ri-instalimin e situate origjinale te modifikuar.

Te gjithe udhezimet e sugjeruara jane subjekt i Standarteve Kombetare dhe Kodeve te aplikuara per Projektimin e Puneve Publike dhe zbatimin e tyre brenda territorit Shqiptar.

Programi i propozuar i Punimeve eshte bazuar ne 5 dite pune per javë dhe ne 8 ore pune per dite.

Ne lidhje me devijimin e trafikut, zgjidhja e propozuar ka avantazhet si me poshte:

- Shmangje e konsumit te tokes bujqesore dhe e shpronesimeve
- Reduktim drastik i kostove shtese mbi buxhetin e alokuar per qellimin kryesor te Projektit.
- Reduktim i kohezgjatjes se per gjithshme te perfundimit te Projektit
- Reduktim drastik i nyjeve gjatesore per gjate struktura se shtresave dhe shtresave te asfaltit te Autostrades se zgjeruar SH2
- Mirembajtje e nje korridori te asfaltuar operacional te emergencies
- Menaxhim i lehte ne klasifikimin e mjeteve sipas kategorive
- Zbutje e konsiderueshme e volumit te trafikut per te menaxhuar sektionet perkohesishet ne dispozicion te Autostrades SH2
- Mundesi per posedim te kantierit nga Kontraktori i Punimeve te segmenteve te zgjatur te Autostrades SH2 per zgjerim
- Teknika me te thjeshta per implementimin e alternimit te trafikut per gjate korsive te Autostrades SH2
- Mirembajtje e shpejteise mesatare per te dyja klasat e mjeteve
- Reduktim i aksidenteve te trafikut
- Shmangje e ngarkesave te trafikut e shoqeruar me zbutje te ndotjes mjedisore.

7.2 Sistemi i menaxhimit te devijimit te trafikut

